

VENDIM
Nr. 106, datë 20.7.2012

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË HEC “ULËZ - SHKOPET” SHA NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2, germa “a”; 9, dhe nenit 45 pika 4, dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.7.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gjerat “a”, “b”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. Ndërsa për pikën “c” të këtij neni, subjekti nuk ka dhënë informacion të detajuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hec Ulëz - Shkopet” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Licenca e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike do t'i fillojë efektet e saj ligjore pas procesit të privatizimit.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani